



Datë: 15.09.2025
Numër Protokolli: 6159/2025

A.nr. 1187/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1187/2025, të datës 20.06.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 53 paragrafi të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Anulohet Vendimi me numër A.nr.486/2025, i datës 05.05.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Mbetet në fuqi Njoftimin për rezultatin përfundimtar me numër 02 Nr. 111-6506/25 i datës 05.03.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës, lidhur me kandidatin fitues sipas konkursit me Nr. Reference: RN00016377 për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme të shpallur nga Komuna e Klinës.

III. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1187/2025, e datës 20.06.2025, e parashtruar nga ankuesja F.R.

A r s y e t i m

Ankuesja F.R (me tej referuar vetëm ankuesja), më datë 20.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1187/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00016377, për Grupin i Përgjithshëm i tatimit -taksave apo mbledhjeve së të ardhurave, për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, me pretendimet ankimore se e kundërshtojë në testi renditjen përfundimtare të datës 09.06.2025 dhe tërë procedurën e rekrutimit për këtë pozitë, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 01.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr. 4217/2025 të datës 20.06.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit për F.R; Konkursin me numër referencë RN00016377, i datës 20.01.2025; Njoftimi i datës 20.02.2025, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës; Njoftimi i datës 09.06.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, i nxjerr Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës; Vendimi me numër protokolli 02. Nr. 112-14897/25, i datës 14.05.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klinës; Vendimi A. Nr. 486/2025, i datës 05.05.2025, i Këshillit; Diplomë me numër protokolli 2570, e datës 09.02.2021, për F.R; së; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025, dërguar përmes emalit, nga K.A për Xh. D; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1187/2025, e datës 04.07.2025; Kërkesën për rekrutim të jashtëm e datës 10.01.2025; Testi me shkrim për Q.P; Emali i datës 12.05.2025, dërguar nga XH.D, për S.GJ; Emalin e datës 19.05.2025, dërguar nga S.Gj, Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 09.06.2025; emali i datës 20.05.2025, dërguar nga Xh.d, dërguar për B.g,F.R etj; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 09.06.2025, për kandidatin Q.P, nga anëtari i komisionit E.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 09.06.2025, për kandidatin Q.P, nga anëtari i komisionit R.Gh; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 09.06.2025, për kandidatin Q.P, nga anëtari i komisionit B.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 09.06.2025, për kandidatin Q.P, nga anëtari i komisionit A.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 09.06.2025, për kandidatin Q.P, nga anëtari i komisionit A.G; ;Lista e aplikantëve; Aplikacioni i F.R, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 2570, e datës 09.02.202, për F.R, e lëshuar nga Universiteti Haxhi Zeka'' Pejë; Vërtetim i datës 08.01.2024; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën nga data 18.03.2019, deri me datën 04.01.2024, për F.R; Aplikacioni i Q.P, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 400/15 e datës 28.03.2015, për Q.P, e lëshuar nga Kolegji AAB; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën nga data 01.03.2021, deri me datën 16.12.2021, për Q.P.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Klinës, më datë 20.01.2025 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016377 për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, klasa e pozitës Profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.01.2025 deri më 19.02.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me datë 30.01.2025 e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim mirëpo e njëjta nuk ka marrë pjesë në testin me shkrim.

Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës me datë 05.03.2025 me numër 02Nr.111-6506/25 ka publikuar Njoftimin për rezultatin përfundimtar për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Drejtorinë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim për kandidatin Q.B. me gjithsejtë 93 pikë.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër njoftimit për rezultatin përfundimtar për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme me numër 02Nr.111-6506/25 të datës 05.03.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2025 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.486/2025, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses të datës 18.03.2025 duke anuluar njoftimin për rezultatet përfundimtare dhe çdo veprim tjetër administrativ deri në fazën e vlerësimit profesional duke e kthyer çështjen në fazën e vlerësimit profesional.

Komuna e Klinës në kuptim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2025 i ka ftuar kandidatët në mesin e tyre edhe ankuesen në testin me shkrim që do të mbaje më datë 28.05.2025, mirëpo rezulton se vetëm një kandidat ka marr pjesë në testin me shkrim, dhe i cili sipas njimtimit për rezultatin përfundimtar të datës 09.06.2025 rezulton si kandidat fitues me gjithsej 89.40 pikë.

Ankuesja kundër njoftimit të rezultatit përfundimtar të datës 09.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me rastin e caktimit të testit me shkrim nuk kemi qenë të njoftuar për testin me shkrim përkundër që në aplikacion kam lënë numrin e kontaktit dhe ka marr pjesë vetëm një kandidat që ka qenë vetëm ai i informuar. Kandidati fitues nuk plotëson kushtet e konkursit sepse ka bashkangjitur vetëm pasqyrën e trustit pa bashkangjitur ndonjë kontratë apo vërtetim të marrëdhënies së punës. Komisioni i pranimit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore, sepse nuk janë tre nëpunës në komision të specializuar në fushën përkatëse dhe po ashtu një është në periudhë provuese. Kërkon të anulohet procedura e pranimit për këtë pozitë.

Kolegji i Këshillit, në procedurë të vendosjes së ankueses, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2025 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.486/2025, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses të datës 18.03.2025 duke anuluar njoftimin për rezultatet përfundimtare dhe çdo veprim tjetër administrativ deri në fazën e vlerësimit profesional duke e kthyer çështjen në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa Komuna e Klinës ka ndërmarr të gjitha veprimet juridike, respektivisht më datë 20.05.2025 i ka ftuar kandidatët e fazës së verifikimit paraprak e në mesin e tyre edhe ankuesen dhe atë në emailin e lënë nga vetë ankuesja me rastin e aplikimit, e ku sipas këtij njoftimi, kandidatët janë njoftuar për kohën e mbajtjes së testit me shkrim i cili është planifikuar të mbahet më datë 28.05.2025, mirë si rezultat i provave të lëndës, konstatohet fakti i pakontestueshëm që ankuesja edhe përkundër njoftimit nuk ka marr pjesë në testin me shkrim, ndërsa në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e njëjta ngrit pretendimet se nuk është njoftuar për testim me shkrim edhe pse kontaktin e ka lënë në aplikacion.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të provave materiale të lëndës, rezulton se ankuesja edhe në herën e parë nuk ka marr pjesë në testin me shkrim edhe pse ka qenë e ftuar mirëpo edhe herën e dytë nuk ka marr pjesë në testin me shkrim, që nëse i referohemi depozitave ligjore në fuqi respektivisht nenit 103 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar: *Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë*, e për rrjedhojë aplikimi i ankueses në këtë konkurs është fillim i një procedure, mirëpo mos pjesëmarrja e ankueses në dy raste në testin me shkrim për këtë pozitë, konsiderohet braktisje e procedurës në kuptim të këtyre dispozitave.

Andaj duke marr parasysh konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“4. E drejta e ankimimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*, si dhe nenit 124 paragrafi 1, të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim”*, kështu që referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se mos pjesëmarrja e ankueses në testin me shkrim edhe pse është njoftuar për mbajtjen e testit me shkrim, nuk mund të konsiderohet veprim që i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me këtë procedurë të pranimit, e përkitazi me këtë Kolegji vlerëson se e njëjta nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.1187/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këtë rrethana, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj*, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që Vendimi me numër A.nr.486/2025 i datës 05.05.2025 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të anulohet me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, sepse rrethanat para dhe pas nxjerrjes së këtij vendimi janë të njëjta, respektivisht ankuesja edhe para edhe pas këtij vendimi nuk ka marr pjesë në testin me shkrim për këtë pozitë, e në rastin konkret, Kolegji i Këshillit konstaton se gjendja faktike sipas Vendimit me numër A.nr.486/2025 të datës 05.05.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është vlerësuar drejtë dhe si rezultat i kësaj i njëjti sipas pikës I të dispozitivit të këtij vendimi është anuluar.

Duke marr për bazë se anulimin e Vendimit me numër A.nr.486/2025 të datës 05.05.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të rrethanave të sipër cekura, Kolegji i Këshillit konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të mbetet në fuqi Njoftimi për rezultatin përfundimtar me numër 02 Nr. 111-6506/25 i datës 05.03.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës, lidhur me kandidatin fitues sipas konkursit me Nr. Reference: RN00016377 për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme të shpallur nga Komuna e Klinës, ngase edhe në rastin e parë kur ankuesja ka parashtruar ankesë kundër këtij njoftimi ankesa ka qenë e palejuar sepse ankuesja me mos pjesëmarrje në testin me shkrim konsiderohet braktisje e procedurës së nisur nga ajo.

Bazuar në konstatimet si më sipër, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dispozitat nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1187/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtes

Eshref Shabani

Kryetar Kolegji

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Flaka Raçi;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së